

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### Përshkrimi i shkurtër i mallit:

Bashkia Gramsh me fondet e veta do të blejë një sasi prej 1540 mst (metër sterë) dru zjarri dhe 6 ton pellet. Në momentin e dorëzimit të druve të zjarrit nga subjekti, ato do të kontrollohen nga përfaqësuesi i Bashkisë. Drutë e zjarrit duhet të janë të stivuara në stivë me lartësi 1m x 1m gjatësi, dhe pastaj do të bëhet matja dhe marrja e tyre në dorëzim, (në rastin kur janë të pa prera, pastaj fillon prerja), në ratin kur janë të prera (në kubik 1 x 1 m/gjerësi x 0.7 m/lartësi), pelleti të jetë në thas (qeska) ku të jetë e shkruar (stamposur) dhe pesha e çdo thesi (qeske).

Drutë e zjarrit do të transportohen dhe dorëzohen nga subjekti i kontraktuar në destinacionet (çerdhet, kopëshët, shkollat, konviktin të shkollës së mesme si dhe zyrat e njësive administrative) të përcaktuara nga Bashkia.

#### Kërkesat teknike:

1. Lloji i druve të zjarrit : lloji ah, mare, mrete.
2. Gjatësia e druve të prera të jetë 30 – 35 cm (mesatarja 30 cm). Në rast të kundërt, për mosplotësim e ketij kushti do të bëhet korrektimi i volumit sipas gjatësisë faktike.
3. Diametri (trashësia) : mbi 4 cm,  
E ndarë si më poshtë:
  - a. Me diametër 4 - 10 cm, të rrumbullakëta dhe të paçara, jo me shumë se 10 % e sasisë;
  - b. Me diametër mbi 10 cm, 90% e sasisë ose e gjithë sasia e kontraktuar. Drutë e zjarrit të janë të çara në funksion të diametrit, me qëllim që të janë të manovrueshme gjatë ngarkimit shkarkimit dhe prerjes së tyre për në sobë.
4. Drutë e zjarrit mund të janë të përziera të njoma apo të thata. Nuk pranohen dru të kalbura e mbeturina dhe nëse rezultojnë do të zbriten nga volumi total.
5. Drutë e zjarrit nuk duhet të janë të bigëzuara dhe gjatesia e degëve të prera nga trupi nuk duhet të jetë mbi 5 cm.
6. Kontraktori ka për detyrë të transportojë, shkarkojë e stivosë drutë sipas orientimit të përfaqësuesit të Bashkisë .
7. Gjatësia e druve të shkurtuara të jetë nga 30 – 35 cm. Mjetet dhe punëtorët do të paguhen nga vetë subjekti.
8. Matja e sasië së furnizimit do të behet me kubikë me përmasa (1 x 1 m/gjerësi x 0.7 m/lartësi) .
9. Materjali drusor (dru zjarri) duhet të jetë dorëzuar në çerdhe,kopshte, shkollat, konviktin të shkollës së mesme si dhe zyrat e njësive administrative, simbas listës bashkangjitur brenda datës 15.11.2022.
10. Pelleti do të përdoret vetëm te kopështi me drekë për kaldajën.
11. Në çmim është përfshirë edhe transporti, shkarkimi dhe stivosja e druve në vendin e caktuar paraprakisht nga Bashkia sipas planit të shpërndarjes, të dhënë nga Bashkia Gramsh.

#### Grupi i punës

Halit Pole

Erionilda Miraka

Flamur Hasa

Ing.Xhelil Muça